

Raporti i monitorimit të zbatimit të ligjit për “Regjistrin e pronarëve përfitues” në industrinë nxjerrëse

Hartuar: **Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë**

Mbështetur: **AMSHC**

Tiranë, Gusht 2022- Prill 2023

Përmbajtja:

- Hyrje**
- Metodologjia**
- Monitorimi**
- Gjetjet**
- Rekomandimet**

a.Hyrje:

Ligj për regjistrin e përfituesve realë është miratuar në vitin 2020, me kërkesën e Moneyval. Në vitin 2021 ky ligj është amenduar përmes një akti normativ të qeverisë dhe po ashtu është amenduar sërish në viti 2022.

Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 maj 2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”.

Në Shqipëri përmes raporteve EITI (Inisiativa për Transparencën e Industrisë Nxjerrëse) ka nisur detyrimi i deklarimit të përfituesve realë që në vitin 2016 si një detyrim që buronte nga kërkesat e EITI ku Shqipëria është vend anëtar që në vitin 2013. Por masa e deklarimit të subjekteve që operojnë në industrinë nxjerrëse ishte afërsisht 34%.

Në vitin 2017 u propozua ligji për transparencën në burimet natyre dhe industrinë nxjerrëse. Ligji kaloi në të gjitha fazat e diskutimit por më pas u pezullua procesi i miratimit pasi qeveria e zgjeroi fushën e zbatimit të deklarimit të pronësisë reale në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe shoqërisë civile si një kërkesë e ardhur nga Moneyval pas monitorimit të fluksit të parave të pista në Shqipëri dhe shkallës së lartë të korrupsionit.

Kërkesa 2.5 e standarteve të EITI u miratua nga bordi ndërkombëtar i iniciativës në vitin 2016. Atëherë u vu kusht që vendet anëtare duhej ta zbatonin atë deri në vitin 2020.

Sipas standartit të EITI rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër të disponueshëm publik të pronarëve përfitues që aplikojnë ose kanë një interes pjesëmarrës në një licencë ose kontratë kërkimi ose prodhimi naftë, gazit ose minierash, duke përfshirë identitetin(të pronarëve të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detajet rreth mënyrës se si ushtrohet pronësia ose kontrolli.

Sekretariati i EITI ka kryer një validim të Shqipërisë në zbatimin e kërkesave të EITI në vitin 2020, duke pasur ndër të tjera në fokus edhe ligjin për regjistrin për Pronarët Përfitues.

Zbatimi i Kërkesës 2.5 për pronësinë përfituese është vlerësuar në Validim që nga 1 janari 2020 sipas kornizës së rënë dakord nga Bordi në qershor 2019. Vlerësimi përbëhej nga një vlerësim teknik që fokusohet në kriteret fillestare dhe një vlerësim të efektivitetit.

Vlerësimi paraprak i Sekretariatit është se Shqipëria ka përmbushur më së shumti objektivin e kërkesës 2.5 që lidhet me transparencën e pronësisë përfituese.

Por janë disa momente të kërkesës 2.5 që nuk janë plotësuar, e para lidhet me trajtimin e personave të ekspozuar politikisht dhe verifikimin e tyre; e dyta me çështjet e transparencës së kompanive të huaja që duhet të ofrojnë më shumë informacion në lidhje me listimin e tyre në bursa etj; e treta me të dhënat që publikohen për pronarin përfitues si datën e lindjes, numri i identitetit, mjetet e kontaktit dhe adresa e banimit.

Ligji nr 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues” është miratuar nga parlamenti në korrik të vitit 2020 me iniciativë të këshillit të Ministrave. 11 deputetë votuan kundër ligjit.

Prej atëherë ligji 112/2020 për “Regjistrin e pronarëve përfitues” është amenduar dy herë. ndërsa janë lëshuar dy vendime të këshillit të ministriave që lidhen me zbatimin e ligjit. Edhe vendimet e mësipërme janë amenduar në vijim me tri vendime të tjera cfarë shpreh një dinamikë të gjerë të ndryshimeve në ligj për shkak të sfidave që janë hasur përgjatë aplikimit të ligjit dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Qëllimi i ligjit është identifikimi i pronari përfitues, i cili është i fundit në pronësi ose ushtron kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik (subjekt tregtar dhe OJF), të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe identifikuar me NUIS/NIPT.

Ligji “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, përbëhet nga 17 nene ndërsa përcakton pronësinë direkte dhe indirekte.

“Pronësi direkte” është pronësia e mbajtur nga një individ prej 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues.

Ndërsa “Pronësi indirekte” është pronësia e mbajtur ose kontroll i ushtruar nga i njëjti individ në një ose më shumë persona juridikë, të cilët veçmas ose së bashku zotërojnë 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues.

Në ligj parashikohet krijimi i Regjistrit të Pronarëve Përfitues, detyrimi për marrjen dhe regjistrimin e të dhënave për pronarët përfitues dhe mënyra e regjistrimit të të dhënave në regjistër.

Sipas ligjit, Regjistri i Pronarëve Përfitues është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre, që mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat respektivë shtetërore, të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse,

si dhe shërben si arkiv elektronik zyrtar dhe siguron transparencën në fushën e pronarëve përfitues.

Në ligj parashikohet aksesimi në regjistrin e pronarëve përfitues, si dhe të drejtat e detyrimit lidhur me të dhënat e regjistruara. Konkretisht, në këtë kre parashikohen të dhënat e regjistruara në regjistër dhe të cilat janë lirisht të aksesueshme dhe publike.

Të dhënat e tjera të pronarëve përfitues, të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, dhe të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme do të mund të aksesohen nga: a) personat e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues vetëm në të dhënat e regjistruara në regjistër për subjektin që ato përfaqësojnë; b) autoritetet kompetente shtetërore, të cilët do të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave mbi pronarët përfitues.

Është parashikuar se çdo person mund të marrë informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, vetëm nëse provon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni.

Në vitin 2022 u bënë edhe amendimet e fundit të ligjit **112/2020**, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar

Pjesa më e rëndësishme e ndryshuar me këtë ligj lidhet me penalitetet të cilat u ulën në mënyrë drastike. Neni 13 është zëvendësuar tërësisht me një nen të ri. Janë ulur nga 500 mijë lekë në 50 mijë lekë gjoba për mosregjistrim fillestar; mosregjistrimi indryshimeve gjobitet 50 mijë lekë nga 500 mijë që ishte më herët, si edhe ka disa ndryshime të tjera.

Po në këtë ligj është vendosur që për ato subjekte që nuk kanë bërë deklaram u transferohen të dhënat nga regjistri tregtar tek ai pronarëve përfitues duke ftuar subjektet që të bëjnë ndryshime nëse kanë.

Aktualisht, kanë regjistruar të dhënat e pronarëve përfitues 38,694 subjekte raportues nga 39,714 subjekte që janë të regjistruara në Regjistrin Tregtar. Pra, përqindja e subjekteve që kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar është 97.43%.

Ndërkohë, Organizatat Jofitimprurëse që kanë regjistruar të dhënat e pronarëve përfitues janë 2376 nga 2376 që janë të regjistruara. Pra, përqindja e subjekteve që kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar është 94.39%.

Në nenin 13 të Ligjit Nr.112/2020 i ndryshuar, parashikohen shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe që dënohen me gjobë. Sa i takon numrit të gjobave të vendosura dhe të paguara deri në fund të janarit 2023 janë si më poshtë:

-92 gjoba në vlerën 400.000 lekë për moregjistrimin fillestar të të dhënave sipas nenit 15/1. Figurojnë të jenë paguar 30 gjoba.

-12 gjoba për mosregjistrim fillestar të OJF-ve sipas gjurmës c), të pikës 3 të nenit 5. Figurojnë të jenë paguar 4 gjoba

-62 gjoba në vlerën 400.000 lekë për mospasqyrim të ndryshimeve faktike të të dhënave të pronarëve përfitues sipas gjurmës ç), të pikës 3 të nenit 5. Figurojnë të jenë paguar 20 gjoba.

QKB-ja dhe autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse për subjektet raportuese, të cilat kryejnë shkeljet e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të aktit të sipërcituar, përveç dënimit me gjobë si më lart, nuk do të ofrojnë shërbimet ndaj tyre, përveç regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të përfaqësuesit ligjor, si dhe do të ndryshojnë statusin për subjektet raportuese nga statusi “aktiv” në statusin “të pezulluar” në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues.

METODOLOGJIA:

Metodologjia mbështetet në tri shtylla:

1.Intervista dhe biseda me aktorë të ndryshëm të përfshirë në çështjet e industrisë nxjerrëse si përfaqësues të organizatave të biznesit, biznese të industrisë nxjerrëse, përfaqësues të institucioneve të menazhimit të industrisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile të përfshirë në monitorimin e industrisë nxjerrëse në vend

2.Monitorimin e deklarave të pronarëve përfitues të subjekteve që operojnë në hidrokarbure dhe minerale

3.Ekspertizë dhe avokim për zbatimin e ligjit „Për regjistrin e pronarëve përfitues“ dhe rritjen e transparencës së pronësisë në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe burimeve natyrore.

1. U përzgjedhën 12 subjekte të biznesit, institucione të menaxhimit të industrisë, shoqërisë civile dhe institucione përgjegjëse për zbatimin e ligjit „Për regjistrinin e pronarëve përfitues“.

Përmes pyetjeve të specifikuara për secilin institucion por edhe pyetjeve të përbashkëta për secilin prej tyre, sipas teknikave të grupit të fokusuar, u synua të krijohet një pamje të kuptimit të tyre mbi ligjin, vështirësitë në zbatimin e tij, nevojat për përmirësim në pjesë të ndryshme të ligjit apo rregulloret e udhëzimet përkatëse, transparencën e institucionit që menaxhon zbatimin e ligjit, përfshirjen e grupeve të interesit në diskutimin e projektligjit apo ndryshimeve të mëvonshme.

AKBN dhe ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk u përgjigjën. Me disa përfaqësues të biznesit u zhvilluan biseda, 2 prej tyre nuk u shprehën në lidhje me pyetjet për shkak të politikave të tyre të brendshme të komunikimit për çështje të tilla.

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të përgjigjeve nga intervistat konkludohet se:

- Shoqëria civile dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në sektorin e burimeve natyrore nuk ka marrë pjesë në diskutimin e draftit të ligjit para miratimit të tij në vitin 2020 por as në rastet e amendimit të tij në vitet në vijim.

- Shoqëria civile konkludon se ligji nuk përmbush kërkesat e EITI për PEP ndërsa propozon uljen e pragut të deklarimit të pronësisë: 1% në rastin e hidrokarbureve dhe 5% në sektorë të tjerë specifike.

- Niveli i lartë i gjobave është dekurajues për procesin e deklarimit dhe është mirëpritur vendimi i qeverisë për faljen e gjobave dhe uljen e tyre në ligj.

- Ne rastin e regjistrimit të subjekteve me pronesi indirekte, subjekti raportues duhet të depozitojë një dokumentacion të plotë shoqerues të leshuar nga autoriteti kompetent regjistruar, për të vertetuar të dhënat e deklaruara për të gjithë subjektet zinxhir, deri në evidentimin e individëve që zoterojnë subjektin.

- Janë parashikuar hapat që duhet të ndermerren nga subjekti raportues në rast se pas shterimit të mjeteve të identifikimit të pronarit përfitues nuk arrihet të përcaktohet individ i që ka në pronesi ose kontrollon i fundit personin juridik me 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose interesave të pronesisë.

- Niveli i regjistrimit të subjekteve është në masën 97%, ndërkohë që janë vendosur 92 gjoba në vlerën 400.000 lekë për më regjistrimin fillestar të të dhënave sipas nenit 15/1. Figurojnë të jenë paguar 30 gjoba.

- 12 gjoba për mosregjistrim fillestar të OJF-ve. Figurojnë të jenë paguar 4 gjoba

-62 gjoba në vlerën 400.000 lekë për mospasqyrim të ndryshimeve faktike të të dhenave të pronarëve përfitues. Figurojnë të jenë paguar 20 gjoba.

-Subjektete e mësipërme janë me status i pezulluar deri në pagimin e gjobës.

-Në lidhje me verifikimin e pronarëve përfitues PEP, kjo gjë mund të bëhet përmes ligjit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë.

2.Skuadra e projektit bazuar mbi listën e subjekteve të ndërtuar nga AlbEITI për raportim për vitin 2020 zgjodhi përqindjen e përcaktuar të subjekteve të industrisë nxjerrëse ku janë pasqyruar edhe të dhëna në lidhje me prodhimin, shitjen, numrin e punonjësve dhe pagesën e rentës minerare.

Janë grumbulluar edhe të dhëna të tjera që lidhen me kompaninë si: numri i lejes të kompanisë, nipti, data e lejes, bashkia ku operon kompania, administratori, drejtuesi teknik, objekti ku punohet, lloji i mineralit që nxirret ose përpunohet, numri i punëtorëve në total dhe numri i punëtorëve me sigurim jete, prodhimi në ton dhe përqindja e cilësisë, prodhimi në m³ dhe përqindja e cilësisë, të ardhurat nga shitja e produktit në vend në lekë ose dollarë, të ardhurat nga shitja jashtë në lekë apo dollarë.

Të gjitha këto të dhëna të krijojnë një panoramë të industrisë në vend dhe ndërkohë verifikojnë edhe nevojën e transparencës së pronësisë për shkak se zhvillojnë pasuri natyrore të vendit që në një mënyrë u përkasin të gjithëve dhe jo vetë atyre që zhvillojnë bizneset.

Duke përcaktuar se renta është pagesa e kompanive në shtet sipas nivelit të shitjes së prodhimit, skuadra e projektit iu referua kësaj të dhëne për të bërë përzgjedhjen sipas madhësisë së kompanive dhe volumit të punës së tyre.

Regjistri ku jemi bazuar përmbajnë 88 subjekte të industrisë nxjerrëse, minerale, naftë dhe gaz të cilat përfaqësojnë afro 90% të prodhimit mineral, naftës dhe gazit në vend.

Ekstrakti i mësipërm është përzgjedhur nga 594 kompani që janë gjithsej në fushën e industrisë nxjerrëse.

Nga regjistri i përcaktuar për raportin vjetor të EITI 2020 me gjithsej 88 subjekte që operojnë në hidrokarbure dhe minerale, janë përzgjedhur për monitorim afërsisht gjysma e tyre 41 kompani minerare dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit në vend.

Theksojmë se në monitorim janë përfshirë të gjitha kompanitë e nxjerrjes së naftës dhe gazit.

Janë përzgjedhur 16 kompanitë më të mëdha në sektorin e kromit, 10 prej të cilave me nga 10 mijë ton mineral prodhim e më shumë, 6 kompani me mbi 5000 ton mineral prodhim; 2 kompanitë më të mëdha në sektorin e bakrit; 4 kompanitë më të mëdha në sektorin e hekur nikelit; 4 kompani nga nxjerrja e gurit gelqeror; 2 kompani nga nxjerrja e argjilës; 2 kompani nga rërat bituminoze; 1 kompani nga gelqeror i mermerizuar; 1 kompani nga nxjerrja e ranor silicor; 1 kompani nga nxjerrja e gips; 1 kompani nga nxjerrja e bazalt.

Për secilën kompani është seleksionuar deklarata e thjeshtë e Pronarëve Përfitues dhe ekstrakti historik i pronësisë.

Deklaratat janë ndarë në deklarata të pronësisë direkte dhe deklarata të pronësisë indirekte.

Varësisht nga problematikat që janë evidentuar në deklaram janë përzgjedhur deklaratat për të cilat kërkohet dokumentacion shtesë për një hetim më të thelluar të pronësisë, deklaratat që janë refuzuar dhe deklaratat që janë refuzuar mbi një herë.

Deklaratat e pronësisë indirekte kalojnë në një proces cross-checking në përpjekje për të arritur tek pronari fundor dhe jo tek administratori fundor që mund të paraqitet si i tillë në një rrjet të tërë kompanish kur ato janë regjistruar në parajsa fiskale ose off shore.

Po ashtu është kryer matja e vështirësisë së deklaramit të pronarëve përfitues nga kompania dhe cilësia e formularit, lehtësia në të kuptuar dhe mundësitë që formulari të jetë lehtësisht i lexueshëm prej personave që nuk kanë njohuri apo dije rreth formateve që përdoren në deklarimet e bizneseve përfshirë edhe pronarët përfitues.

3. Shtylla e tretë e metodologjise ka te beje me advokimin e përmirësimit të ligjit dhe përshtatjen e tij me nevojat për rritjen e transpencës dhe njohje sa më të thellë të ligjit dhe të zbatimit të tij përmes publikimit të gjetjeve të monitorimit si dhe ekspertizës.

Kjo fushatë avokimi përfshiu:

a)prezantimin e gjetjeve përpara një grupi gazetarësh permes email. Gjetjet dhe rekomandimet e projektit u shpërndanë përmes email marketing në një listë prej 150 gazetarësh që mbulojnë çështje që lidhen me ekonominë , politikën dhe aktualitetin.

b)prezantimin në MSG (grupi ndërinstytucional) i Alb EITI në ministrinë e Infrastrukturës ku janë anëtarë përfaqësues nga disa ministri, organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të grupeve më të mëdha të kompanive që janë të përfshira në industrinë nxjerrëse;

c)Një ekspertizë shoqëruar me propozimin për amendime në ligj lidhur me uljen e përiqindjes për deklarim të pronarëve përfitues është dërguar në komisionin e Punëve Prodhuese, Tregtsë dhe Mjedisit në Kuvend;

d) Janë publikuar tre artikuj në lidhje me gjetjet kryesore në media online, dy prej të cilave lidhen kryesisht me nevojën e uljes së pragut të deklarimit të pronësisë reale.

e) Të gjitha produktet e projektit si raporti me gjetjet dhe propozimet, ekspertiza me propozimin për uljen e pragut të deklarimit të pronësisë si dhe tri artikujt që do të publikohen në një media online u marketuan në rrjete sociale përmes një buxheti të ndarë për këtë qëllim. Po ashtu u publikua një njoftim shtypi në lidhje me propozimet e projektit.

Marketingu arriti në një audiencë rreth 150 mijë ndjekës të rrjeteve sociale të përzgjedhur përmes targetimit në zonat ku ka kryesisht indsutri nxjerrëse si Fier, Bulqizë, Librazh, Pogradec, Kukës, Pukë, Mirditë, Shkodër, Tropojë, Skrapar, Vlorë. Matja e audiencës së arritur u krye përmes google analytics.

MONITORIMI

Në vijim janë të dhënat e siguruara për secilën kompani:

A. KOMPANITË E NAFTËS

1.Bankers Petroleum

Nipti: K43128401L **Emri i Subjektit:** BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD **Pronar:** Huanqin Xiao (Shtetësia:Kineze)

Pronësi: Indirekte, regjistrimi në parajsa fiskale, Ishujt Kajman, 7 pronarë përfitues te shoqerise Sherëood International Petroleum Ltd

Përfundime: Kompania ka pronësi indirekte pa mundësi identifikimi. Janë 7 pronarë sipas nipteve të regjistruar në Ishujt Kajman.

Shtetasi kinez Huanqin Xiao, i datelindjes mars 1964 mban pozicionin e drejtuesit me te larte te subjektit raportues qe ne daten 01.08.2022.

Pronaret perfitues te shoqerise Sherëood International Petroleum Ltd nuk jane identifikuar. Ne ekstrakt jane dhene numrat e regjistrimit te pronareve indirekt te Sherëood International Petroleum Ltd:

2. Anio Oil&Gas Sha (ish.Trans Atlantik Albania Ltd

Nipti: K72205016P **Emri i subjektit:** TRANSATLANTIC ALBANIA Ltd. - Dega Shqiptare **Pronar:** Naim Kasa (Shtetësia:Shqiptar/e)

Pronësi: Direkte, regjistruar në parajsa fiskale ishujt Kajman (GBC Oil Compani LTD)

Shënim: Është e dyshimtë përcaktimi si pronësi direkte për sa kohë kompania shqiptare është përfaqësues i një kompanie të regjistruar në parajsa fiskale. Sipas Çertifikatës së Themelimit, datë 11.06.2007, të dorëzuar në QKB, TRANSATLANTIC ALBANIA LTD (Ish Stream Oil & Gas Ltd) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e përjashtuar nga taksat, e themeluar në Ishujt Cayman si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që prej datës 11.06.2007

3. Delvina Gas Company

Nipti: L61416039U **Emri i Subjektit:** Delvina Gas Company

Pronar: Sokol Meqemeja (Shtetësia:Shqiptar/e). Deklarata e pronësisë është miratuar menjëherë.

Pronësia: Indirekte, regjistruar në parajsa fiskale British virgin islands. Është deklaruar 90% nuk njihet 10%.

Sipas statutit të shoqërisë së huaj, datë 13.01.2016, të dorëzuar në QKB, Delvina Gas Company Ltd është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më datë 13 janar 2016 dhe që funksionon sipas ligjeve të British Virgin Islands, e regjistruar me numër regjistrimi 1903568, me seli në Jayla Place, Eickhams Cay 1, Road Toën, Tortola, British Virgin Islands, me administrator Chad D. Burkhardt

4. Transoil Group AG (IEC Visoka Shp)

Nipti: L11725004I **Emri i Subjektit:** Terraoil Sëiss **Përfaqësues:** Shefqet Dizdari (Shtetësia:Shqiptar/e).

Pronësi: Indirekte, e huaj regjistruar në Zvicër, Ortaket e shoqerise jane: Peter Krempin me 31.4% te kapitalit, Shefqet Dizdari me 31.4% te kapitalit dhe 470 ortake te vegjel me 37.2% te kapitalit ne total.

Statusi: Miratuar, refuzuar dy herë aplikimi

Shënim: Nuk njihen pronarët e 37.2 të biznesit (470 ortakë të vegjël)

Sipas të dhënave të Zefix- Central Business Name Index (regjistrin tregtar të Zvicres), datë 11.03.2022, dhe faqes zyrtare te shoqerise <https://terraoil.sëiss/>, Terraoil Sëiss AG (Ish Transoilgroup AG, Ish TERRAOIL SËISS INC, Ish TERRAOIL SËISS SA), një shoqëri e themeluar në 24.08.2010 dhe që funksionon sipas ligjeve të Zvicrës, me numër identifikimi në regjistrin tregtar të Zvicrës (UID) CHE-115.925.456, me seli në Industriestrasse 47, CH-6300 Zug, Zvicer, me drejtor Hans-Peter Vogt, Shefqet Dizdari, Frank Gregor Eettstein, Peter Krempin, Silvio Campestrini. Ortaket e shoqerise jane: Peter Krempin me 31.4% te kapitalit, Shefqet Dizdari me 31.4% te kapitalit dhe 470 ortake te vegjel me 37.2% te kapitalit ne total.

5. Fin Pek Petroleum

Emri i Subjektit: FIN PEK PETROLEUM **Nipti:** L01410008B.

Pronësia: Indirekte e verifikueshme:

Përqindja pronësisë: 40.000% Eduart Muho, dhe pjesa tjetër Silvi Oil & Drilling me pronësi të Eduart Muho 100%.

Statusi: Miratuar menjëherë.

Vërejtje; Formulari është I ngatërruar për një person që nuk është I akomoduar mirë me natyrën e deklaramit dhe formatet e tij.

Shënim: Brenda një kohë të shkurtër prej 2 vitesh kanë ndryshuar dy herë pronarët gjithsej 6 (2012-2014) sipas ekstraktit historic të kompanisë në QKB

6.

Alpetrol

(Nuk ka bere deklarim pronesie) si kompani aksionere shteterore nuk ak detyrim të bëjë deklarim për përfituesit e pronësisë

7. Shell upstream

Nipti: L21807009I **Emri i Subjektit:** Shell Upstream Albania B.V

Përfaqësues: Anthonie Marinus Frens (Shtetësia:Holandeze); **Emri i Subjektit:** Shell Upstream Albania B.V **Nipti:** L21807009I

Statusi: Aplikimi për pronarin përfitues I miratuar menjëherë.

Pronësia; Indirekte holandeze, regjistruar në Hollandë. E pamundur arritja tek pronari përfitues individ por vetëm person juridik. Shenohet me zero në të gjitha rastet. Nuk duhej të ishte miratuar regjistrimi I pronarit përfitues sipas regjistrit të publikuar nga QKB.

Sipas te dhenave te Regjistrit Tregtar te Hollandes deri me date 11.03.2022, Shell Upstream Albania BV eshte nje shoqeri e themeluar ne daten 13.10.2011 dhe e regjistruar ne regjistrin tregtar te Hollandes ne daten 27.10.2011, e organizuar sipas ligjeve te Hollandes, me numer regjistrimi 53833317, me adrese ne Carel van Bylandtlaan 30, 2596 HR, The Haaglanden region, Arendsdorp, Hage, Hollande, me administratore Robert Deutman, Dorine Yvonne Christine Elise Marie dhe Tatiana Vladimirovna Stepanova.

Shell Upstream Albania BV eshte nje shoqeri e zoteruar nga grupi financiar ROYAL DUTCH SHELL plc, e regjistruar ne daten 25.09.2002, me numer ne regjistrin tregtar te Hollandes 34179503, me adrese te njejte ne Carel van Bylandtlaan 30, Hague, Hollande. ROYAL DUTCH SHELL plc ka ne zoterim pjeserisht ose plotesisht 159 shoqeri te tjera te regjistruara ne regjistrin tregtar te Hollandes. Shell Upstream Albania BV eshte ne nivelin e katert te struktures se grupit.. Sipas Ekstraktit Historik te Regjistrit te Pronarit Perfitues, date 26.04.2021, terhequr nga QKB ne daten 11.03.2022,

Anthonie Marinus Frens, shtetas holandez, i datelindjes 1964, mban pozicionin e drejtuesit/drejtuesve më të lartë të subjektit raportues qe ne daten 10.11.2020.

Përfundime për industrinë e naftës:

-Regjistrimi i përfituesve të pronësisë në industri nuk është bërë sipas kërkesave të ligjit ose ato të dhëna nuk janë reflektuar në ekstraktet e publikuara të kompanive. Duke lexuar ekstraktet nuk kuptohet në 4 raste se kush është pronar i kompanive të naftës në Shqipëri.

Formulari nuk tregon përqindjen e pronësisë edhe në ato raste kur theksohet emri i individit pronar përfitues.

Në një rast të pronësisë direkte nuk njihet pronari për 10% (është e ligjshme), në një tjetër nuk njihet pronari për 37.2%, në një tjetër nuk njihet përqindja e individit por edhe e subjektit juridik, (Shell upstream është me përfaqësim, pronësia nuk shifër pasi është shënuar me zero); 2 kompani të jera nuk kanë të dhëna për përqindjen e pronësisë (Bankers dhe Anio oil& gaz sha), pavarësisht se konsiderohet se kompanitë kanë regjistruar pronësinë dhe ajo është miratuar nga QKB.

-Nga 6 kompani të shfrytëzimit të nafës, gazit dhe kërkimit në naftë e gaz, që të gjitha paraqesin pronësi indirekte; 3 prej tyre janë të regjistruar në parajsa fiskale mes të cilave pronarët e Bankers Petroleum që kanë afro 80 përqind të shfrytëzimit të rezervave të naftës.

-2 kompani të tjera janë të regjistruara përkatësisht në Hollandë dhe Zvicër; Kompania Shell Upstream pa mundësi verifikimi të pronarit përfitues ndërsa TerraOil me pronarë përfitues të verifikuar pjesërisht.

-1 kompani është me pronësi indirekte, e regjistruar në Shqipëri me pronarë përfitues të identifikuar.

- 1 kompani (Anoil&gaz) është i paqartë përcaktimi si pronësi direkte për sa kohë kompania shqiptare është përfaqësues i një kompanie të regjistruar në parajsa fiskale.

-1 kompani, Albpetrol nuk është deklaruar në regjistrin e pronarëve përfitues për shkak se ligji nuk e detyron si kompani me aksioner të vetëm shtetin.

-Nga 6 kompani, 5 prej tyre kanë marrë menjëherë miratimit e deklarimit të pronarëve përfitues, 1 kompani është refuzuar dy herë, herën e tretë është pranuar aplikimi.

-1 kompani ka shume transaksione me aksionet në një periudhë të shkurtër (2012-2015), 10 të tillë ndërsa shitja e deklaruar e pronësisë është në vlera të vogla (25% nga 4000 dollarë deri në 50 mijë dollarë).

B. KOMPANITE E KROMIT

1. Xhireton

Nipti: J71909005P **Emri i Subjektit:** XHIRETON **Pronar:** Asim Zajmi
(Shtetësia:Shqiptar/e) Data e përcaktimit:12/05/1995

Lloji i pronësisë: Pronësi direkte, përqindja pronësisë: 100.000%, deklarata e pronarit përfitues është refuzuar 2 herë, më pas është miratuar.

2. Alb Canaj

Nipti: K07729901Ë **Emri i Subjektit:** "ALB-CANAJ" SHPK

Pronar: Urim Canaj (Shtetësia:Shqiptar/e Data e përcaktimit:01/22/2004

Emri i Subjektit: "ALB-CANAJ" SHPK

Datë aplikimi: 25-05-2021 **Statusi:** Miratuar Aplikimi

Pronësia: Direkte, identifikuar me kryqëzim të dhënash për pronarin me 20%, 80% Urim Canaj; 20% Ardit Duma. Miratuar aplikimi menjëherë.

3. Damba e fabrikes se pasurimit te kromit Bulqize

Nipti: K06626418M **Emri i Subjektit:** FABRIKA E PASURIMIT TE KROMIT
BULQIZE

Pronar: Bukurosh Koçi (Shtetësia:Shqiptar/e) Data e përcaktimit:06/05/2012

Pronësia: Direkte, përqindja pronësisë: 100.000%, miratuar aplikimi menjëherë.

4. Egi-K

Nipti: K77424401L **Emri i Subjektit:** EGI-K

Pronar: Eduart Keta (Shtetësia:Shqiptar/e) Data e përcaktimit:11/23/2001

Pronësia: Direkte, verifikuar, 100%, Miratuar aplikimi.

Shënim: PEP i dyshuar, në 2015 ka një vendim revokimi të lejes minerare nga ministri Gjiknuri për shkak të mbivendosjes së lejes.

5. Klervibris

Nipti: K86328401E **Emri i Subjektit:** KLERVIBRIS

Pronësia Direkte, verifikuar 50% me 50%; Ardian Hida; Luciano Koceku. Ndryshim pronari 1 herë. Miratuar aplikimi pas është refuzuar 3 herë.

6. Drini Bulqizë

Nipti: K47220402N **Emri i Subjektit:** Drini Bulqizë

Pronar: Ilir Cami

Pronësi direkte, 50%-50%. Aplikimi i miratuar menjëherë.

Shënim:Themeluar si kompani turistike.adrese në Vlorë, në 2002, në 2010 leje për eksport kromi, adrese në Bulqizë.

7. ALB LEAA International

Nipti: J86906408N **Emri i Subjektit:** ALB LEAA INTERNATIONAL

Pronar: Arben Zhuku

Pronësia: Direkte, 100%, aplikimi i miratuar menjëherë.

8. Aris Albania, Bulqizë

Bulqizë Emri i subjektit Aris Albania, NIPT: K97114401A

Pronësia: Direkte, aksioneri kryesor me 40%, verifikuar edhe 3 aksionerët e tjerë me 15% secili përmes kryqëzimit të të dhënave, aplikimi i refuzuar 2 herë dhe pastaj imiratuar.

9. ZASHA

Nipti: K82217010F **Emri i Subjektit:** ZASHA

Pronësi direkte, 100%, Aplikimi në regjistrin e pronarëve përfitues për këtë kompani ka 3 vendime brenda një dite, 1 miratim e 2 refuzime

10. Gerti shpk

Nipti: J96829417K **Emri i Subjektit:** GERTI

Pronësia: Direkte Përqindja pronësisë: 100.000%, aplikimi i miratuar menjehere.

Shënim: Kompania është themeluar 1999; pezulluar per 5 vjet (2011-2016)

11. Illyria Minerals Industri sh.p.k

Nipti: L01629005J **Emri i Subjektit:** ILLYRIA MINERALS INDUSTRY(IMI)

Pronar: Akin Atik (Shtetësia:Turke Data e përcaktimit:08/03/2012

Pronësia: Direkte, e huaj, turke, 100%, është refuzuar dy herë aplikimi dhe pastaj është pranuar.

12. Kukes Chrome Minerals

Nipti: L08412202M **Emri i Subjektit:** Kukes Chrome Minerals

Pronar: Eduart Seitaj (Shtetësia:Shqiptar/e)

Pronësia: Direkte, 50 Eduart Seitaj; 40 % Petrit Koldashi, Gentian Cerrraga 10%, aplikimi i refuzuar njëherë dhe pastaj miratuar.

13. Ballenja

Nipti: L06825401U **Emri i Subjektit:** "BALLENJA"

Pronar: Rrahim Dedja (Shtetësia:Shqiptar/e)

Pronësia: Direkte, përqindja pronësisë: 100.000%, aplikimi i miratuar menjëherë

14. Kosturr Kromi

Nipti: L77818201F **Emri i Subjektit:** KOSTURR KROMI

Pronar: JIELIN LIU (Shtetësia:Kineze) Data e përcaktimit:06/26/2018

Pronësia: Indirekte, me pronarë kompania kineze 51%, Iljaz Spahiu 6%, Keli Kasharaj 18%, Blerimi kosturr 2010, 25%. Aplikimi I refuzuar dy herë dhe pastaj miratuar

Shënim:Ka mosperputhje mes ekstraktit te thjeshte apo historik te kompanise dhe te dhënave te regjistruara ne regjistrin e pronarëve përfitues (si edhe në disa raste të tjera regjistri i pronësisë; ekstrakti i thjeshtë dhe ai historik është mjaft i komplikuar për tu kuptuar në rastin e pronësisë mes shumë pronarëve apo pronësisë indirekte)

15. Canameti

Nipti: L46802702E **Emri i Subjektit:** CANAMETI

Përfaqësues: Shkelqim Cevani (Shtetësia:Shqiptar/e)

Pronësi direkte, 3 aksionerë shqiptarë, aplikimi është refuzuar 4 herë brenda ditës, pastaj është pranuar.

16.Albchrome

Nipti: K11613001M **Emri i Subjektit:** Albchrome

Pronar: ALI RIZA YILDIRIM (Shtetësia:Turke)

Pronësi indirekte, turke, miratuar aplikimi menjëherë. 50.000%, YUKSEL YILDIRIM

Përfundime:

-Ka vështirësi kuptimi të ekstraktit të thjeshtë apo historik të pronarëve përfitues në rastin e pronësisë indirekte.

-Është vetëm një rast i dyshuar PEP, por ka pronarë përfitues që nuk duket se kanë shumë lidhje me industrinë (pronarë auditues). (Egi K, PEP i dyshuar, data e themelimit: 23/11/2001, në 2015 ka një vendim revokimi të lejes minerare nga ministri Gjyknuri për shkak të mbivendosjes së lejes)

-Nga këndvështrimi i zbatimit të ligjit të regjistrimit të pronësisë, kompanitë e kromit kanë hasur vështirësi në regjistrimin e pronarëve përfitues. 8 kompani e kanë regjistruar atë menjëherë, 8 të tjera janë regjistruar pas refuzimit, 4 raste pas dy refuzimeve, 1 rast pas një refuzimi, 2 raste pas 3 refuzimeve dhe 1 rast pas 4 refuzimeve.

-Në kompanitë e kromit 14 kompani janë me pronësi direkte dhe dy me pronësi indirekte (një turke dhe një kineze).

-Në një rast konsiderohet se pronari përfitues ka lidhje me PEP.

-11 kompani të kromit kanë pronësi të identifikueshme në 100% të saj ndërsa 5 kompani nuk kanë identifikim në 100% të saj, ose 7 raste të pronarëve përfitues ku mbajnë pronësi më pak se 25%. Është e mundur të identifikohet pronësia përmes kryqëzimit të të dhënave në rastet kur ajo është pronësi direkte, por jo kur ajo është pronësi indirekte.

C. KOMPANITË E BAKRIT

1.

Nipti: K12107002A **Emri i Subjektit:** BERALB **Pronar:** EROL KOHEN
(Shtetësia: TURKE)

Pronësia: Indirekte, 72 përqind e pronësisë e identifikuar, pjesa tjetër nuk është përcaktuar si ndahet mes dy kompanive turke që kanë për pronar përfitues Kohen në 50% dhe 100%. Për Beralb QKB ka refuzuar dy herë aplikimin dhe është miratuar 1 vit pas detyrimit të deklarimit të pronarëve përfitues.

Shënim: Dy kompani turke pronare ndërsa një person fizik kinez që mban edhe pozicionin e drejtuesit/drejtuesve më të lartë të subjektit raportues, që nuk është e njëjtë me të qenit pronar përfitues. Koncesioni është nga 2001 deri në 2041.

2. TETE ALBANIA TUNNEL & MINING

Nipti: K71627041B **Emri i Subjektit:** TETE ALBANIA TUNNEL & MINING

Pronësia: Indirekte, turke, aplikimi është refuzuar një herë dhe më pas është miratuar. Dy kompani turke 49% dhe 51%. Janë të identifikuar dy pronarët përfitues nga dy kompanitë turke.

Përmbledhje: Industria e bakrit ka dy kompani me pronësi indirekte dominuar nga bizneset turke të regjistruar në Turqi dhe një pronar përfitues kinez.

Në një kompani është identifikuar pronari përfitues prej 72%, ndërsa kompania tjetër ka të identifikuar 85% të pronësisë.

Në të dy rastet aplikimet e regjistrimit të pronësisë janë refuzuar përkatësisht një herë dhe dy herë.

D. KOMPANITË E FE-NI

1. AFRIMI K

Nipti: K07713216Q **Emri i Subjektit:** AFRIMI K **Pronar:** Astrit Dobrush

Pronësia: Direkte, 100% miratuar aplikimi direkt. (Pronati është nëtar i këshillit bashkiak të Kukësit).

2. Victoria Invest International

Nipti: L02712202J **Emri i Subjektit:** Victoria Invest International **Pronar:** Fatmir Kuçi

Pronësia: Direkte, shqiptare 100%

3. MINING FERRO NIKEL

Nipti: L31929015F **Emri i Subjektit:** MINING FERRO NIKEL **Pronar:** Sibe Azemi

Pronësia: Direkte, 100%, miratuar aplikimi menjëherë

4. Kastrioti Construcion

Nipti: L17609201R **Emri i Subjektit:** KASTRIOTI
CONSTRUCTION **Pronar:** Kastriot Dobrusha (Shtetësia:Shqiptar/e Data e
përcaktimit:01/21/2011

Pronësia: Direkte 100%, miratuar aplikimi menjëherë.

Përmbledhje: Nga 4 kompani Fe-Ni, të gjitha me pronësi direkte, shqiptare.
Aplikimi në regjistrin e pronarëve përditues është miratuar menjëherë

1 pronar anëtar i këshillit bashkiak

E. GUR GELQEROR

1.

Nipti: K92110004Q **Emri i Subjektit:** XYZ 08 **Pronar:** Anton Gjinaj

Pronësia: Indirekte e identifikuar, 100.000%, miratuar aplikimi menjëherë

Shënim: Sekuestruar, pronari Anton Gjinaj në burg për trafik droge në Spanjë.

2.

Nipti: K04226216O **Emri i Subjektit:** BABASI-2 **Pronar:** Bashkim Babasi

Pronësia: Direkte, 50% me 50%, familjarë të një ish deputetit (PEP), miratuar
aplikimi menjëherë.

3. Lim Em

Nipti: K22218005O **Emri i Subjektit:** LIM - EM

Pronësia: Direkte, 50%-50%, miratuar menjëherë. Pronarë, Ardian Beshiri,
Shkelqim Beshiri

4. Gur gelqeror Roirmar

Nipti: K82214015H **Emri i Subjektit:** ROIRMAR **Pronar:** Robert Pasko

Pronësia: Direkte 100%, miratuar menjëherë, 100 pronar Robert Pasko (i regjistruar edhe ne parajsat fiskale me nje kompani Monte Alba Shipping, ne Malte)

Përmbledhje: Nga katër subjekte me gur gelqeror, të gjitha ajnë me pronësi direkte nga 50% deri në 100%, pronësi shqiptare.

1-kompani e sekuestruar nga SPAK pronari u gjet trafikant dorge

1-kompani, pronari i saj ka të regjistruar biznes në parajsa fiskale, Maltë.

1-kompani me lidhje politike PEP

F. ARGJILË

5. F.K.C.F Fushe Kruje, Seament Albania NIPT: J61827093K

Pronësi indirekte, e huaj, Seament pronësi 80%, 20% nuk dihen; refuzuar dy herë aplikimi, pastaj miratuar.

Shënim: Fabrika e çimentos Fushë Krujë Sh.p.k. është themeluar më 14 shtator 2000 nga blerja e pasurisë së Ndërmarrjes se Prodhimit të çimentos ne Fushë Krujë (fabrika e dytë më e madh e çimentos në vend) nga një konsorcium i drejtuar nga Seament Holding ne Liban. Zotëron edhe Elbasan Cement factory 78%

6. Antea Cement

Nipti: K61914005R **Emri i Subjektit:** ANTEA CEMENT

Pronësi indirekte, e huaj greke-qipriote, refuzuar tri here,miratuar heren e katërt. Nuk është e mundur të njohen pronarët pëfitues

Nuk duhej të ishte regjistruar; nuk publikohet pronësia, kompanitë që e pronësojnë Antea Cemenet, janë 5 person juridik pronar indirekt.

(ALVACIM LIMITED, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me adrese te regjistruar ne Qipro, Arch. Makariou III, 2-4 CAPITAL CENTER, kati 9, P.C 1065 Nicosia, perfaqesuar nga Pandeli Garo. Sipas Akt themelimit dhe Statutit te Shoqerise,MARIO BRACCI është CEO i Antea dhe jo pronar)

Përmbledhje: Industria e cimentos është në pronësi indirekte, greke-qipriote dhe libaneze, pronarët të papërcaktuar vetëm në një rast tek Seament Albania, libanezi është me pronësi 80% por nuk dihen të tjerët me 20%.

Antea Cement nuk duhej të ishte regjistruar. Nuk janë përshkruar aksionet e pronarit përfitues.

-Industria zotërohet nga dy operatorë, në kushte oligopoli.

G. RËRAT BITUMINOZE

7. Selenicë Bitumi

Nipti: K16815202M **Emri i Subjektit:** SELENICE BITUMI **Pronar:** Michel Pavoine

Pronësia: Indirekte, franceze, miratuar menjëherë, Pronar përfitues, Michel Pavoine, 2001. Pronësia 100% nga kompania KLP Mine S.A.S Përfitues 3 subjekte juridike

8. Alb industri

Nipti: L23402205B **Emri i Subjektit:** ALB-INDUSTRI

Pronësia: Direkte, tre pronarë të identifikuar me 25%. 25%,32.5%. Pronësia 17.5% është e pidentifikuar. Miratuar menjëherë.

Përfundime: Për grupin rëra bituminoze, pronësia është e ndarë mes asaj direkte dhe indirekte. Ka një pronar të huaj francez Selenicë Bitumi dhe të paktën 3 pronarë shqiptarë tek Alb Industri.

Aplikimet në regjistrin e pronarëve përfitues janë miratuar menjëherë.

1 kompani ka 17.5% të pidentifikuar.

H. Gelqeror i mermerizuar

9.

Nipti: J74517209B **Emri i Subjektit:** BABASI COO **Pronar:** Ndriçim Babasi

Pronësia: Direkte, 100%, shqiptare, miratuar menjëherë, Pronar:Ndririm Babasi, ish deputet, kompania regjistruar më 1998.

I. RANOR SILICOR

10. Emri i Subjektit: ALBANERA NIPT:K49719204I

Statusi: Refuzuar aplikimi dy herë, vijon të mos ketë aplikim të miratuar.

Dy pronarë ortakë, Margarita dhe Krenar Fezga me nga 50% secili. Regjistruar në 2005.

11.

Nipti: J74517202O **Emri i Subjektit:** XHULIO

Pronësia: Direkte 100%, pronar Adrian Gjura, miratuar menjëherë.

K. Bazalt

12.

Emri i Subjektit: BALKAN BASALT **Nipti:** L41504022N **Numri i aplikimit:** RPP2021063022274871541504022 **Datë aplikimi:** 30-06-2021

Pronesia: Indirekte, pronar De Oude Poel Holding B. V. Kompani hollandeze; administrator Maurice Nicolaas Maria Martens; themeluar në 2014, aktivitet në Lezhë.

Statusi: Refuzuar Aplikimi, Nuk ka regjistruar të dhëna në regjistrin e Pronarëve përfitues. Është pezulluar spas ligjit të pronarëve përfitues deri në pagesën e gjobës dhe regjistrimin në regjistër.

Përfundime: Për grupin gelqeror i mermerizuar, ranos silicor, gips dhe bazalt kemi dy kompani të paregjistruar në regjistrin e pronarëve përfitues nga 4 kompani të përzgjedhura për monitorim.

Pronësia është e ndarë në 3 kompani është shqiptare ndërsa në një kompani është e huaj. Ose kemi 3 kompani me pronësi direkte, 1 me pronësi indirekte.

Ndër dy kompanitë që është refuzuar aplikimi vetëm njëra Balkan Bazalt rezulton e pezulluar në QKB deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e rregullt sic parashikohet nga ligji. *(Bazuar në nenin 15/1 të ligjit Nr. 6/2022 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.112/2020, Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar, QKB për subjektet raportuese, të cilat kryejnë shkeljet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, do të ndryshojë statusin nga "AKTIV" në statusin "PEZULLUAR" deri në pagesën e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues)*

PËRFUNDIME SIPAS SEKTORËVE TË INDUSTRIË:

Përfundime: Kompanitë e naftës dhe gazit

-Regjistrimi i pronarëve përfitues në industri nuk është bërë sipas kërkesave të ligjit ose ato të dhëna nuk janë reflektuar në ekstraktet e kompanive. Duke lexuar ekstraktet nuk kuptohet në 4 raste se kush është pronar i kompanive të naftës në Shqipëri.

Formulari nuk tregon përqindjen e pronësisë edhe në ato raste kur theksohet emri i individit pronar përfitues.

-Nga 6 kompani të shfrytëzimit të nafës, gazit dhe kërkimit në naftë e gaz, 5 deklarohen me pronësi indirekte; 3 prej kompanive janë të regjistruar në parajsa fiskale mes të cilave pronarët e Bankers Petroleum që kanë afro 80 përqind të shfrytëzimit të rezervave të naftës; 2 kompani të tjera janë të regjistruara përkatësisht në Hollandë dhe Zvicër; Kompania Shell Upstream pa mundësi verifikimi të pronarit përfitues ndërsa Terraoil me pronarë përfitues të verifikuar pjesërisht.

-1 kompani është me pronësi indirekte, e regjistruar në Shqipëri me pronarë përfitues të identifikuar.

- 1 kompani (Anioil&gaz) është i paqartë përcaktimi si pronësi direkte për sa kohë kompania shqiptare është përfaqësues i një kompanie të regjistruar në parajsa fiskale.
- 1 kompani, Albpetrol nuk është deklaruar në regjistrin e pronarëve përfitues për shkak se ligji nuk e detyron si kompani me aksioner të vetëm shtetin.
- Nga 6 kompani, 5 prej tyre kanë kryer deklarinimin e pronësisë me sukses.
- 1 kompani është refuzuar dy herë, herët e tretë është pranuar aplikimi.
- 1 kompani ka ndryshim pronarësh në një periudhë të shkurtër, 6 të tillë ndërsa shitja e deklaruar e pronësisë është në vlera të vogla (25% nga 4000 dollarë deri në 50 mijë dollarë).
- Në një rast të pronësisë direkte nuk njihet pronari për 10% (është e ligjshme), në një tjetër nuk njihet pronari për 37.2%, në një tjetër nuk njihet përqindja e individit dhe subjekteve juridikë, (Shell upstream është me përfaqësim); një kompani nuk ka të dhëna për përqindjen e pronësisë (Anio oil& gaz sha), pavarësisht se konsiderohet se kompania ka regjistruar pronësinë dhe ajo është miratuar nga QKB.

Kompanitë e kromit

- Ka vështirësi kuptimi të ekstraktit të thjeshtë apo historik të pronarëve përfitues, nuk del qartë ku flitet për kompaninë që pronëson dhe kompanisë në shqyrtim.
- Është vetëm një rast i dyshuar PEP, por ka pronarë përfitues që nuk duket se kanë shumë lidhje me industrinë (pronarë auditues). (Egi K, PEP i dyshuar, data e themelimit: 23/11/2001, ne 2015 ka nje vendim revokimi te lejes minerare nga ministri Gjiknuri per shkak te mbivendosjes se lejes)
- Nga këndvështrimi i zbatimit të ligjit të regjistrimit të pronësisë, kompanitë e kromit kanë hasur vështirësi në regjistrimin e pronarëve përfitues. 8 kompani e kanë regjistruar atë menjëherë, 8 të tjera janë regjistruar pas refuzimit , 4 herë pas dy refuzimeve, 1 herë pas një refuzimi, 2 herë pas 3 refuzimeve dhe 1 herë pas 4 refuzimeve.
- Në kompanitë e kromit 14 kompani janë me pronësi direkte dhe dy me pronësi indirekte (një turke dhe një kineze). 3 nga kompanitë e kromit janë me pronësi të huaj, dy turke dhe një kineze.
- Në një rast konsiderohet se pronari përfitues ka lidhje me PEP.

-11 kompani të kromit kanë pronësi të identifikueshme në 100% të saj ndërsa 5 kompani nuk kanë identifikim në 100% të saj, ose 7 raste të pronarëve përfitues ku mbajnë pronësi më pak se 25%. Është e mundur të identifikohet pronësia përmes kryqëzimit të të dhënave në rastet kur ajo është pronësi direkte.

Industria e bakrit ka dy kompani me pronësi indirekte dominuar nga bizneset turke të regjistruar në Turqi dhe një pronar përfitues kinez.

Në një kompani është identifikuar pronari përfitues prej 72%, ndërsa kompania tjetër ka të identifikuar 85% të pronësisë.

Në të dy rastet aplikimet e regjistrimit të pronësisë janë refuzuar përkatësisht një herë dhe dy herë.

Nga 4 kompani Fe-Ni, të gjitha janë me pronësi direkte, miratuar menjëherë pronari përfitues, 1 pronar është anëtar i këshillit bashkiak

Nga katër subjekte me gur gelqeror, të gjitha janë me pronësi direkte nga 50% deri në 100%, pronësi shqiptare.

1-kompani e sekuestruar nga SPAK pronari u gjet trafikant dorge

1-kompani, pronari i saj ka të regjistruar biznes në parajsa fiskale, Maltë.

1-kompani me pronar PEP

Industria e cimentos është në pronësi indirekte, greke-qipriote dhe libaneze, pronarët të papërcaktuar vetëm në një rast tek Seament Albania, libanezi është me pronësi 80% por nuk dihen të tjerët me 20% (pavarësisht se nuk është kërkesë e ligjit për këtë përqindje).

Për Antea Cement nuk është e qartë se si është plotësuar formulari i pronësisë. Nuk janë përshkruar aksionet e pronarit përfitues.

-Industria zotërohet nga dy operatorë, në kushte oligopoli.

Për grupin rëra bituminoze, pronësia është e ndarë mes asaj direkte dhe indirekte. Ka një pronar të huaj francez Selenicë Bitumi dhe të paktën 3 pronarë shqiptarë tek Alb Industri.

Aplikimet në regjistrin e pronarëve përfitues janë miratuar menjëherë.

1 kompani ka 17.5% të pidentifikuar.

Për grupin gelqeror i mermerizuar, ranos silicor, gips dhe bazalt kemi dy kompani të paregjistruar në regjistrin e pronarëve përfitues nga 4 kompani të përzgjedhura për monitorim.

Pronësia në 3 kompani është shqiptare dhe direkte ndërsa në një kompani është e huaj me pronësi direkte.

Ndër dy kompanitë që është refuzuar aplikimi vetëm njëra Balkan Bazalt rezulton e pezulluar në QKB deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e rregullt sic parashikohet nga ligji. *(Bazuar në nenin 15/1 të ligjit Nr. 6/2022 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.112/2020, Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar, QKB për subjektet raportuese, të cilat kryejnë shkeljet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, do të ndryshojë statusin nga "AKTIV" në statusin "PEZULLUAR" deri në pagesën e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues)*

PËRFUNDIME PËRMBLEDHËSE:

Janë regjistruar të dhënat e pronarëve përfitues 38,694 subjekte raportues nga 39,714 subjekte që janë të regjistruar në Regjistrin Tregtar, ose ndryshe 97.43%.

Janë vendosur 92 gjoba në vlerën 400.000 lekë për moregjistrimin fillestar të të dhënave. Janë paguar 30 gjoba.

Janë vendosur 62 gjoba në vlerën 400.000 lekë për mospasqyrim të ndryshimeve faktike të të dhënave të pronarëve. Figurojnë të jenë paguar 20 gjoba.

Kampioni i përzgjedhur:

Regjistri ku jemi bazuar përmbajnë 86 subjekte të industrisë nxjerrëse, minerale, naftë dhe gaz të cilat përfaqësojnë afro 90% të prodhimit mineral, naftës dhe gazit në vend nga 594 kompani që janë gjithsej në fushën e industrisë nxjerrëse.

Nga registri i përcaktuar për raportin vjetor të EITI 2020 janë përzgjedhur për monitorim afërsisht gjysma e tyre 41 kompani minerare dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit në vend.

Në monitorim janë përfshirë të gjitha kompanitë e nxjerrjes së naftës dhe gazit.

Janë përzgjedhur 16 kompanitë më të mëdha në sektorin e kromit, 10 prej të cilave me nga 10 mije ton mineral prodhim e më shumë, 6 kompani me mbi 5000 ton mineral prodhim; 2 kompanitë më të mëdha në sektorin e bakrit; 4 kompanitë më të mëdha në sektorin e hekur nikelit; 4 kompani nga nxjerrja e gurit gelqeror; 2 kompani nga nxjerrja e argjilës; 2 kompani nga rërat bituminoze; 1 kompani nga gelqeror i mermerizuar; 1 kompani nga nxjerrja e ranor silicor; 1 kompani nga nxjerrja e gips; 1 kompani nga nxjerrja e bazalt.

-Për kompanitë e mineraleve, 23 kompani janë me pronësi direkte, 2 kompani janë refuzuar në aplikim, njëra prej tyre rezulton e pezulluar. 7 kompani në pronësi indirekte, kryesisht turke, kineze, hollandeze, franceze, italiane greko qipriote. Një kompani shqiptare është e regjistruar në parajsë iscale, Maltë dhe një tjetër në Qipro.

-20 kompani janë regjistruar për pronësinë që me aplikimin e parë, 12 kompani janë regjistruar pasi janë refuzuar nga 1-4 herë, përkatësisht 3 kompani refuzuar nga një herë; 5 kompani nga 2 herë; 3 kompani nga tre herë; 1 kompani 4 herë;

-23 kompani i kanë pronarët të verifikueshëm në të gjithë segmentin e pronësisë ndërsa 10 kompani kanë pjesë të pronësisë të paverifikueshme, në disa raste brenda kufijve të ligjit dhe në disa raste përtej kufijve ligjorë. 2 kompani kanë dështuar të raportojnë pronarët përfitues.

Përfundime për industrinë e naftës: Regjistrimi i përfituesve të pronësisë në industri nuk është bërë sipas kërkesave të ligjit ose ato të dhëna nuk janë reflektuar në ekstraktet e publikuara të kompanive. Duke lexuar ekstraktet nuk kuptohet në 4 raste se kush është pronar i kompanive të naftës në Shqipëri.

Formulari nuk tregon përiqndjen e pronësisë edhe në ato raste kur theksohet emri i individit pronar përfitues.

Në një rast të pronësisë direkte nuk njihet pronari për 10% (është e ligjshme), në një tjetër nuk njihet pronari për 37.2%, në një tjetër nuk njihet përqindja e individit por edhe e subjektit juridik, (Shell upstream është me përfaqësim); një kompani nuk ka të

dhëna për përqindjen e pronësisë (Anio oil& gaz sha), pavarësisht se konsiderohet se kompania ka regjistruar pronësinë dhe ajo është miratuar nga QKB.

-Nga 6 kompani të shfrytëzimit të nafës, gazit dhe kërkimit në naftë e gaz, që të gjitha paraqesin pronësi indirekte; 3 prej tyre janë të regjistruar në parajsa fiskale mes të cilave pronarët e Bankers Petroleum që kanë afro 80 përqind të shfrytëzimit të rezervave të naftës.

-2 kompani të tjera janë të regjistruara përkatësisht në Hollandë dhe Zvicër; Kompania Shell Upstream pa mundësi verifikimi të pronarit përfitues ndërsa Terraoil me pronarë përfitues të verifikuar pjesërisht.

-1 kompani është me pronësi indirekte, e regjistruar në Shqipëri me pronarë përfitues të identifikuar.

- 1 kompani (Anioil&gaz) është i paqartë përcaktimi si pronësi direkte për sa kohë kompania shqiptare është përfaqësues i një kompanie të regjistruar në parajsa fiskale.

-1 kompani, Albpetrol nuk është deklaruar në regjistrin e pronarëve përfitues për shkak se ligji nuk e detyron si kompani me aksioner të vetëm shtetin.

-Nga 6 kompani, 5 prej tyre kanë marrë menjëherë miratimit e deklarimit të pronarëve përfitues, 1 kompani është refuzuar dy herë, herët e tretë është pranuar aplikimi.

-1 kompani ka ndryshim pronarësh në një periudhë të shkurtër, 6 të tillë ndërsa shitja e deklaruar e pronësisë është në vlera të vogla (25% nga 4000 dollarë deri në 50 mijë dollarë).

Përfundime të tjera:

Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 maj 2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”.

Ligji për regjistrin e përfituesve të pronësisë ka pasur vetëm një koment gjatë diskutimit në Parlament nga Dhoma e tregtisë dhe Bashkimi i Dhomave. Nuk janë ftuar në diskutim përfaqësues të shoqërisë civile, vecanërisht ato organizata që kanë dije apo lidhen me përvoja të deklarimit të pronarëve përfitues si rrjeti shqiptar i shoqërisë civile AlbnetEITI.

Informacioni për identitetin e pronarit përfitues sipas kërkesave të EITI nuk përputhet plotësisht me kërkesat e ligjit për Regjistrin e Pronarëve përfitues. (Regjistri duhet të

përfshijë emrin e pronarit përfitues, kombësinë dhe vendin e banimit, datëlindjen si dhe identifikimin e çdo personi të ekspozuar politikisht (PEP). Rekomandohet gjithashtu që të zbulohet numri i identitetit, data e lindjes, adresa e banimit ose e shërbimit dhe mjetet e kontaktit).

Ligjin 112/2020 për “Regjistrin e pronarëve përfitues” është amenduar dy herë ndërsa janë publikuar dy vendime të këshillit të ministrave që lidhen me zbatimin e ligjit. Edhe vendimet e mësipërme janë amenduar në vijim me tri vendime të tjera cfarë shpreh një dinamikë të gjerë të ndryshimeve në ligj dhe aktet nënligjore për shkak të sfidave që janë hasur përgjatë aplikimit të ligjit dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Të dhënat e regjistruara në regjistër që janë publike për të gjithë sipas ligjit janë lirisht të aksesueshme.

Cdo person mund të marrë informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, vetëm nëse provon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni. Përcaktimi në ligj është relativ kur një kërkesë e tillë nuk vjen nga institucionet e listuara, dhe i jep pushtet më të madh titullarit të institucionit ta vendosë këtë gjë.

Në raportet EITI për vitet fiskale 2015 dhe 2016 të publikuara përkatësisht në shkurt të vitit 2017 dhe në shkurt 2018, është bërë deklaram vullnetar të Pronarëve Përfitues. Në Raportin EITI 2015 nga 134 kompani raportuese vetëm 31 kompani kanë dhënë informacion për Pronarët Ligjor dhe / apo Përfitues dhe në Raportin EITI 2016 nga 141 kompani raportuese, 32 kompani kanë dhënë informacion për Pronarët Ligjor dhe / apo Përfitues.

Shqipëria kishte disa elemente të transparencës së pronareve përfitues në Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” si dhe ligjin Nr .9049, date 10.4.2003 “Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publike”.

-Në propozimin e draftligjit për Transparencën propozuar nga AlbEITI parashikohej që rastin e shoqërive të cilat nuk kryejnë aktivitete ekonomike, por veprojnë si ndërmjetës, pragu i zbatueshëm do të ulet në 10%. Kjo nuk është marrë parasysh në ligjin e 112/2020.

-Ndërsa pronësia direkte është e lehtë të identifikohet, tek pronësia indirekte do të jetë e nevojshme një kryqëzim të dhënash dhe shpesh përplasje me barriera të institucioneve që nuk sigurojnë transparencën. *(Ne rastin e regjistrimit te subjekteve me pronesi indirekte, subjekti raportues ne perputhje me parashikimet e Ligjit Nr.*

112/2020 i ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 1088, datë 24/12/2020, i ndryshuar, duhet të depozitohet një dokumentacion të plotë shoqëruar me leshuar nga autoriteti kompetent regjistruar, për të vertetuar të dhënat e deklaruara për të gjithë subjektet zinxhir, deri në evidentimin e individëve që zoterojnë subjektin.

Në Kreun III të VKM-së Nr. 1088, datë 24/12/2020, i ndryshuar parashikohen hapat që duhet të ndermerren nga subjekti raportues në rast se pas shterimit të mjeteve të identifikimit të pronarit përfitues nuk arrihet të përcaktohet individ që ka në pronësi ose kontrollon i fundit personin juridik me 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose interesave të pronësisë).

-Përfituesit realë të pronësisë duhet të kontrollohen përmes *cross-checking* dhe se rruga përmes konsultimit të taksës mbi dividendin është një mënyrë që mund të përdoret vetëm nga institucione të përzgjedhura në ligj. Ligji i ri për tatimin mbi fitimin e ka të detyrueshme zbulimin e emrave që janë përfitues të dividendit.

-Ligji Nr. 112/2020 nuk parashikon verifikimin e vertetësisë së deklaratave dhe institucioni nuk e kryen këtë verifikim.

-Nuk është shpjeguar se si veprohet për ato kompani tek të cilat të gjithë aksionerët e saj kanë më pak se 25% aksione. A regjistrohen ato?

REKOMANDIME:

-Parlamenti të krijojë një regjistër të grupeve të interesit për ligje të caktuara përmes një kërkimi dhe konsultimi me institucionet e lidhura me ligjin në proces, por edhe nga regjistri i organizatave të shoqërisë civile etj. Ligji për regjistrin e përfituesve të pronësisë ka pasur vetëm një koment gjatë diskutimit nga Dhoma e tregtisë dhe Bashkimi i Dhomave. Nuk janë ftuar në diskutim përfaqësues të shoqërisë civile, vecanërisht ato organizata që kanë dije apo lidhen me përvoja të deklaramit të pronarëve përfitues si rrjeti shqiptar i shoqërisë civile AlbnetEITI.

-Të shtohet vendbanimi tek dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, të cilat do të jenë lirisht të aksesueshme dhe publike. Aktualisht janë të dhëna lirisht të aksesueshme: a) emri dhe mbiemri i pronarit përfitues; b) shtetësia; c) viti dhe muaji i lindjes; ç) data e përcaktimit të individit si pronar përfitues; d) lloji dhe përqindja e pronësisë: - direkte - indirekte.

Vendbanimi është shtuar në ligj përmes Aktit Normativ Nr. 12, datë 25.03.2021, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 49, datë 29.03.2021

-MSG duhet të nisë një proces avokimi për të ndryshuar pragjet e deklarimit të Pronarëve Përfitues për sektorin specifik të industrisë nxjerrëse dhe për PEP në këtë industri, për të siguruar përafrimin e kërkesave EITI 2.5.d ku thuhet se *“Informacioni për identitetin e pronarit përfitues duhet të përfshijë emrin e pronarit përfitues, kombësinë dhe vendin e banimit, si dhe identifikimin e çdo personi të ekspozuar politikisht. Rekomandohet gjithashtu që të zbulohet numri i identitetit kombëtar, data e lindjes, adresa e banimit ose e shërbimit dhe mjetet e kontaktit”*.

-Shqipëria është e njohur gjerësisht si vend me një administratë publike me korrupsion endemik. Rekomandojmë deklarimin e pronësisë me një prag prej 10% për industrinë nxjerrëse për të dekurajuar përfshirjen e zyrtarëve të administratës në biznese në kushtet e konfliktit të interesit.

-Kur identifikohen Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP), propozohet që pragu të ulet edhe deri 1%

-Gjobat edhe pse janë ulur, sërish janë të mëdha. Vendosija e gjobave duhet të zëvendësohet me trainime mbështetur në teknika dixhitale të aksesueshme për të gjithë në mënyrë ‘friendly’ edhe për ata që kanë njohuri të pamjaftueshme për proceset e aplikimit të pronësisë në platforma online.

-Mbajtja e regjistrit të Pronarëve Përfitues mund të ishte më e pranueshme ti ngarkohej një institucioni të vecantë duke i shtuar edhe detyrën e verifikimit me short apo përzgjedhje sipas peshës ekonomike dhe detyrimit për deklaram.

-Ligjvënësi duhet të bëjë një përcaktim të qartë të pronësisë indirekte.

NDJEKJA:

Përsa i përket përmbushjes së kërkesës 2.5 të Standartit EITI për BO dhe rekomandimeve të lëna nga Validimi i fundit, Albeiti ka parashikuar në Grantin e ri që pritet të merret nga Banka Botërore një Shërbim Konkulencë i cili do të bëjë vlerësimin e impaktit të këtij Ligji. Me përfundimin e këtij studimi dhe daljen e konkluzioneve dhe të rekomandimeve do të diskutohet dhe vendoset sesi do të adresohen problematikat e mundshme.

Shenim: “Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të AMSHC-së. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AMSHC-së”.